



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

# Buletini

Publikim  
dymujor  
Viti X  
Nr.58  
Janar-Shkurt  
2013

AKK-ja anëtar i  
Komisionit për  
ndryshim-  
plotësimin e  
Ligjit për  
Financat Lokale

Bordi i AKK-së  
miraton raportet  
e 2012 dhe  
përcakton  
planet për  
vitin 2013

Programi  
identifikues i  
SDC-së takoi  
Bordin e  
AKK-së

Aktivitetet e  
Kolegjiumeve  
në përcaktimin  
e prioriteteve  
për vitin 2013

**Rekomandimet e AKK-së**  
për Projektligjin për Ndryshimin dhe  
plotësimin e Ligjit nr.03/L-181 për  
Inspektoratin dhe mbikqyrjen e Tregut

Lajme  
nga  
Komunat e Kosovës

## AKK-ja anëtar i Komisionit për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Financat Lokale

Në muajin shkurt 2013, me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit është themeluar Komisioni Qeveritar për Hartimin e Draftit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Në këtë Komision anëtar do të jetë edhe Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës

dhe dy anëtar tjerë nga Komunitet e Republikës së Kosovës. Poashtu Asociacioni i Komunave të Kosovës do të jetë edhe bartës i procesit të të gjitha aktiviteteteve lidhur me ndryshim-plotësimin e këtij projektligji në rrafshin e pushtetit lokal. Siç dihet AKK-ja vazhdimisht lobon dhe mbron interesat e Komunave nëpër komisione e grupe pune të ndryshme qeveritare lidhur me aktet ligjore që preken edhe sferën e pushtetit lokal.

## Programi identifikues i SDC-së takoi Bordin e AKK-së

Një delegacion në nivel ekspertësh vizitoi AKK-në ku u takua me Bordin e AKK-së lidhur me mundësitë e bashkëpunimit me komunat e Kosovës dhe investimeve në infrastrukturë. Ky takim u tha se është vetëm miqësor dhe për të përmbledhur sfidat dhe nevojat e komunave. Poashtu projekti i ardhshëm i SDC-së pritet të ketë më shumë investime në infrastrukturën e Komunave. SDC-ja u tha se ka një horizont të hapur për bashkëpunim me AKK-në dhe Komunat e Kosovës.



Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli fillimisht falenderoi delegacionin e ekspertëve të SDC-së për bashkëpunimin e deritashëm mes AKK-së dhe Qeverisë Zvicrane. Kryetari Ismajli me pas bëri një elaborim të strukturave të AKK-së dhe projekteve e aktiviteteteve që po ndërmerr Asociacioni i Komunave në shërbim të interesave të pushtetit lokal në Kosovë.

Kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli më pas prezantoi synimet e AKK-së në periudhën e ardhshme ku tha se decentralizimi i plotë i kompetencave në nivelin lokal është në të mirë të shërbimeve më efikase për nevojat e qytetarëve tanë. Duke ditur faktin se dera e parë e ankesës së qytetarit është komuna, kryetari Ismajli tha se komunat aktualisht kanë probleme në harmonizimin e raportit mes kërkesave të qytetarëve dhe mundësi të komunave. Çështjet e

financave lokale aktualisht janë sfidat tona kryesore, shërbimet tona nuk janë të plota për mungesë kompetencave e buxhetit, nuk ka buxhet shtesë nga qeveria për mirëmbajtjen e projekteve të realizuara. Kurse si sfida që duhet adresuar më urgjent ai tha se është projekti për ngritjen e të hyrave vetenake, proceset e integritit evropian, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje dhe inkurajimi në projektet e partneritetit publiko-privat.

Poashtu kryetari Ismajli dënoi tendencat për të shkurtuar grantin prej 10 për qind në 8 për qind për komunat nga granti i përgjithshëm i buxhetit të Kosovës dhe kjo tendencë nëse realizohet është një goditje e rëndë për pushtetin lokal sepse cenon prioritetet dhe objektivat e Komunave të Kosovës.

Kurse kryetari i Gjilanit dhe anëtar i Bordit të AKK-së z.Qemajl Mustafa

tha se nuk mund të flitet për përrbyllje të procesit të decentralizimit pa siguruar burime shtesë për kompetencat e bartura viteve të fundit. Lidhur me investimet kapitale nuk respektohet formula e granteve, Ministritë nuk bazohen në nevojat e komunave por 'dëshirat' e tyre. Ka raste kur një komunë e vogël merr trefish më shumë projekte nga ministritë se komunat tjera të mëdha. Kryetari Mustafa tha se aktualisht Kosovës i nevojitet një projekt i qëndrueshëm zhvillimor dhjetëvjeçar nga i cili do të duhej të dilnin strategjitë sektoriale.

Delegacioni i ekspertëve të SDC-së poashtu kanë mbajtur edhe një takim të veçantë me Kryesuesit e Kolegjiumeve Profesionale të AKK-së për të parë nga afër nevojat dhe synimet e Kolegjiumeve të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

## AKK-ja koordinohet me partnerët e saj

Për të koordinuar aktivitetet e organizatave që merren dhe punojnë me pushtetin lokal në Kosovës, edhe këtë vit Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takim "Miqtë e AKK-së". Takimet tashmë tradicionale të AKK-së me partnerët e saj kryesore që punojnë në fushën e qeverisjes lokale kanë vazhduar edhe këtë vit. Për këtë arsye u mbajt takimi i përbashkët për të koordinuar aktivitetet dhe evitimit të përsëritjeve të angazhimeve e aktiviteteve. Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim para të pranishmëve paraqiti raportin vjetor të punës së AKK-së për vitin 2012 dhe planin e punës për vitin 2013, ku u identifikuan objektivat dhe synimet për angazhime të përbashkëta në fusha të veçanta të pushtetit lokal në Kosovë edhe në varësi të objektivave të strategjisë



legjislative të qeverisë qendrore. Nga diskutimet e të pranishmëve u identifikua nevoja për bashkëpunim forcash në amandamentimin e ligjit për financat lokale, në projektet e të hyrave vetenake të komunave, trajnime të ndryshme për zyrtarët komu-

nal. Poashtu përfaqësuesit e partnerëve të Asociacionit të Komunave të Kosovës paraqiten planet dhe objektivat e tyre për vitin 2013 dhe mundësitë e fuzionimit të angazhimeve të përbashkëta në projekte të ndryshme.

## Bordi i AKK-së miraton raportet e 2012 dhe përcakton planet për vitin 2013

Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës mbajti mbledhjen e rradhës dhe të parën në këtë fillim viti. Në këtë takim anëtarët e Bordit diskutuan lidhur me propozim raportin vjetor për vitin 2012, propozim buxhetin e AKK-së për vitin 2013, strategjinë legjislative e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013, propozim planin e punës së AKK-së për vitin 2013 dhe të tjera. Mbledhjen e hapi dhe e drejtoi kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli i cili paraqiti rendin e ditës për anëtarët e Bordit. Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim paraqiti para anëtarëve të Bordit propozim raportin vjetor për vitin 2012 i cili u tha se është gjithëpërfshirës dhe prezantues dhe si i tillë u miratua nga ana e Bordit. Në pikën lidhur me Propozim Buxhetin e AKK-së për vitin 2013 u tha se duhet që pagesat e anëtarësisë së komunave të bëhen në bazë të numrit të ri të banorëve të dalë nga Regjistrimi i fundit i popullësisë, mirëpo kjo çështje mbeti të ndryshohet në Kuvendin e AKK-së si organi më i lartë dhe kompetentë për këtë çështje. Propozim



Buxheti 2013 i AKK-së u miratua me unanimitet. Ndërsa lidhur me Strategjinë legjislative e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013 dhe përcaktimi i ligjeve ku AKK-ja do të jap kontributin e vetë, me theks në ligjin për financat lokale. Poashtu Bordi kërkoi që të bëhet presion që të përshpejtohet arrdha në fuqi e Ligjit që rregullon të ardhurat e zyrtarëve të institucioneve përfshirë edhe ata komunal. Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës kërkoi që të shikohet mundësia e amandamentimit edhe të Ligjit mbi Policinë për shkak se mundësisë së krijimit të bazës

ligjore për më shumë bashkëpunim dhe koordinim mes policisë dhe komunave. Ndër ligjet tjera që do të duhej të bëhej presion për amandamentim është edhe Ligji për Prokuorimin Publik ndërsa nga Ligji për Ndërmarrjet Publike duhet të rregullohen disa çështje organizative të cilat mund të bëhen me anë të akteve nënligjore. Në këtë mbledhje Bordi i AKK-së miratoi edhe Planin e Punës së AKK-së për vitin 2013 dhe u njoftua lidhur me një projekt të SDC-së për investime në infrastrukturë nëpër komunat e Kosovës.

## Lajme nga Komunitat

### DEÇAN: Drejtorja e Bujqësisë mban takim me fermerët e komunës

Të pa kënaqur me kriteret të cilat i ka përcaktuar Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për format e subvencionimit dhe përfitimit të grantëve janë shprehur fermerët e Komunës së Deçanit, gjatë takimit informues rreth "Subvencioneve dhe Granteve për bujqësisë- 2013". Fermerët pasi dëgjuan nga zyrtaret komunal në detaje mënyrat e subvencionimit dhe të përfitimit Granteve, thanë se Ministria po i favorizon bujqitë e mëdhenj dhe po i anashkalojnë fermerët e vegjël. Mehmet Osaj pjesëmarrës në këtë takim tha se "MBPZHR-ja u jep mundësi që të përfiton një fermer i cili ka të mbjellur 1 hektarë më misër, në komunën tonë mund të jenë maksimum 3 fermerë që mbjellin një sasi të tillë, prandaj ministria do të ishte mirë që të subvencionoj ata që mbjellin në sipërfaqe me të vogla sepse në këtë formë ndihmohet zhvillimi i bujqësisë" tha Osaj. Tahir Berisha një kultivues i lopëve të qumështit, po ashtu i pa kënaqur me kriteret e vena nga Ministria tha se "Unë kam 30 krerë, unë nuk them se nuk është e nevojshme që të mos subvencionohem edhe unë, po do ishte mirë që këtë subvencionim ta përfitoj edhe ai që i ka vetëm 5 krerë lopë" tha Berisha. Pavarësisht këtyre pakënaqësive të fermerëve Deçanas, zyrtarë të Drejtorisë Komunalë të BPZHR-së në detaje bënë prezantimin se çka mund të përfitojnë fermerët Deçanas nga 27 milion e 50 mijë eurot që i kanë ndarë për subvencionim dhe grante Ministria e Bujqësisë.

## Aktivitetet e Kolegjiumeve në përcaktimin e prioriteteve për vitin 2013



Gjatë muajit janar dhe shkurt Kolegjiumet e AK-së kanë shqyrtuar disa projektligje si dhe kanë përcaktuar prioritetet e tyre vjetore. Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor ka mbajtur një takim të rregullt dhe ka shqyrtuar Projektligjin për Planifikim Hapësinor. Kolegjiumi për Inspektorë ka shqyrtuar Projektligjin për Inspektoratin dhe mbikqyrjen e tregut. Kolegjiumi për Buxhet e Financa ka shqyrtuar Projektligjin për financat e pushtetit Lokal.

**Prioritetet e Kolegjiumeve për vitin 2013:**

#### Kolegjiumi i Kryesues të Kuvendeve Komunale

1. Infrastruktura ligjore
2. Avancimi i mëtejme i punës së Kuvendeve Komunale.

#### Kolegjiumi për Shërbime Publike

1. Funkcionalizimi dhe Përmirësimi i Shërbime Publike në Komuna
2. Plotësimi dhe zbatimi i kornizës ligjore
3. Planet komunale për menaxhimin e mbeturinave

#### Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

1. Forcimi i shërbimeve për fëmijët në ngarkesë të Qendrave për Punë Sociale të Kosovës, për arsye familjare
2. Decentralizimi dhe zbatimi i kompetencave në fushën e shëndetësisë dhe sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm për

ofrimin e shërbimeve shëndetësore

#### Kolegjiumi për Zhvillim Ekonomik Lokal

1. Krijimi i kushteve më të mira për bizneset
2. Menaxhimi i pyjeve dhe tokës bujqësore

#### Kolegjiumi për Buxhet dhe Financa

1. Ndryshim-plotësimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal
2. Procesi i planifikimit buxhetor komunal

#### Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjor

1. Shqyrtimi i projektligjeve që janë në procedurë të hartimit ose plotësim-ndryshimit
2. Përmirësimi i obligimeve ligjore të komunave, që rrjedhin nga ligji

#### Kolegjiumi për Administratë

1. Infrastruktura ligjore për drejtorinë e administratës komunale
2. Përmirësimi i shërbimeve administrative në komunë

#### Kolegjiumi i Inspektorëve

1. Kompletimi i legjisllacionit për fushën e inspeksionit
2. Bashkëpunim më i ngushtë në institucionet relevante për zhvillim të mëtutjeshëm të inspektoratit komunal.

#### Kolegjiumi për Integritet Integritet Evropiane

1. Plani i Veprimit për Studimin e Fizibilitetit – MSA
2. Roli i zyrtarëve komunal për integritet evropiane.

## UNICEF i interesuar për bashkëpunim me AKK-në dhe Komunitet e Kosovës

Udhëheqësja e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë znj.Laila Omar Gad vizitoi zyret e AKK-së ku u prit nga Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahimimi me bashkëpunëtorë. Në këtë takim drejtori Ibrahimimi paraqiti një rezumë të punës dhe aktiviteteteve të

Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe projektet aktuale me të cilat po punon kjo organizatë. Nga ana e saj znj.Omar Gad prezantoi objektivat për aktivitetet dhe projektet e zyrës së saj në sferën e pushtetit lokal me theks në shëndetësi, arsim dhe

mirëqenie sociale. Në këtë takim u debatua edhe lidhur me mundësitë e bashkëpunimit konkret në disa fusha të qeverisjes lokale mes UNICEF-it dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës.

### Lajme nga Komunitet

#### GJAKOVË: Qeveria lokale kërkon bashkëpunim me qytetarët për ruajtjen e ambientit

Qeveria lokale e Gjakovës në vazhden e projekteve dhe angazhimeve të përhershme për mirëmbajtje të pastër të ambientit, kërkonin bashkëpunim me qytetarët që me në sajë të ndërgjegjës së tyre të japin kontributin e drejtpërdrejtë për një mirëqenie ekologjike. Në veçanti në kuadër të bashkëpunimit dhe angazhimit me qytetarët kërkohet që një kontribut të tillë ta japin me përkushtimin e tyre ndaj hapësirave të pastërta duke mos hudhur mbeturina në hapësira joadekuate ku për pasojë krijohen deponi të egra dhe një imazh aspak i mirë dhe i ndotur që mund të sjellë edhe pasoja tjera.

Po ashtu kërkohet qytetarët që mos të vazhdohet me hedhjen e mbeturinave në lumenjë posaçërisht në lumin Krena ku edhe përkundër disa ndërhyrjeve në vazhdimësi për pastrim megjithatë nga disa qytetarë vazhdohet me hudhje masive të mbeturinave të cilat ndalojnë në shtratin e lumit dhe më pas imponohen edhe reagime tjera për pastrim që nuk rezultojnë e mjaftueshme për shkak të dukurisë.

Për të japur kontributin si qytetarë për një ambient të pastër, të gjelbërt dhe të shëndoshë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike apelohet që të kryhen edhe obligimet financiare ndaj kompanisë rajonale të mbeturinave "Çabрати", me qëllim të funksionimit me sukses të duhur të saj.

Për një ambient të pastër kontributin mund ta jep secili qytetarë në forma dhe mënyra të ndryshme, në radhë të parë duke treguar ndërgjegjshmëri në ruajtje të vazhdueshme të saj që është pikënisje për një zhvillim dhe ambient më ekologjik çfarë e duan dhe e meritojnë gjithë qytetarët papërzjashtimisht.

#### GJILAN: "Ecohigjiena" përruron objektin e ri

Kompania "Ecohigjiena" në Gjilan, që vepron në partneritet me kompaninë austriake "Moser Group", ka përruruar objektin e ri. Qemajl Mustafa, kryetar i Gjilanit, tha se partneri publiko-privat në "Higjiena" është projekti që është përrkrahur nga të gjithë vendimmarrësit komunalë dhe tani po shihen rezultatet e këtij partneriteti.

Musatafa tha se "Higjiena" nuk ka pasur të hyra vetanake për investime. Edhe tani ka të hyra modeste, tha ai, por u shpreh i sigurt se kjo kompani, tani me emërtimin "Ecohigjiena" do të forcohet në të ardhmen. Ai falënderoi investitorin austriak që ka zgjedhur Gjilanin për të investuar kapitalin e tij. "Këto investime të huaja dëshmojnë se Gjilani ka klimë të mirë të sigurisë dhe jemi të renditur krejt lart sa i përket klimës për të bërë biznes", tha Mustafa.

Kurse kryetari i Bordit të "Ecohigjiena", Kristian Moser, ka thënë se po hapet një kapitull i ri për kompaninë. Ky investim tregon se ne kemi filluar seriozisht të punojmë në këtë projekt të përbashkët dhe jemi të bindur se do t'i sjellë vetëm të mira qytetit të Gjilanit, ka thënë ai. Moser tha se pos infrastrukturës, e cila tashmë është moderne, "Ecohigjiena" synon që ta avancojë edhe anën profesionale dhe kujdesin ndaj klientëve. "Kujdesi për ambientin është thelbësor dhe se tashmë kemi nisur të shpërndajmë edhe kazanët e mbeturinave në tërë qytetin", ka thënë Moser.

Bajram Isufi, kryeshëf ekzekutiv i kompanisë, tha se planet e tyre nuk përrfundojnë me objektin e ri, që ofron kushte shumë më të mira për punë, porse do të vazhdojnë me tjera, deri në 1.5 milionë euro, siç e parasheh marrëveshja e partneritetit me kompaninë austriake.

Deri tani kemi investuar mbi 300 mijë euro në blerjen e kazanëve të rinj familjarë dhe kolektiv, ndërkohë që sapo jemi pajisur edhe me dy kamionë të prodhimit gjerman për bartjen dhe shkarkimin e mbeturinave, ka thënë Isufi.

## Lajme nga Komunat

### GRAÇANICË: Faza e katërt e Planit Zhvillimor Komunal

Komuna e Graçanicës, në bashkëpunim me Programin e Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor të Komunave, i cili është implementuar nga ana e UN-HABITAT – it, ka organizuar punëtorinë dy-ditore për hartimin e fazës së katërt të Planit Zhvillimor Komunal të Graçanicës (PZHK). Ekipi komunal për hartimin e PZHK të Graçanicës dhe UN-HABITAT-it, në bashkëpunim me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Ambientit kanë mbajtur një punëtori dy-ditore për hartimin e fazës së katërt të PZHK –it " Plani i Veprimit për Zhvillimin e Komunës së Graçanicës 2013-2028". Pjesëmarrësit e punëtorisë ishin përfaqësuesit e Komunës së Graçanicës, UN-HABITAT – it dhe Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Ambientit, si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Në fillim të punëtorisë janë prezantuar rezultatet e arritura nga tri fazat e mëparshme të Planit Zhvillimor. Pjesëmarrësit ishin ndarë nëpër grupe tematike, ku ata punuan në hartimin e Planit të Veprimit. Plani i Veprimit është punuar në bazë të qëllimeve dhe objektivave nga të cilat kanë rrjedhur projektet më prioritare. Përveç kësaj, në kuadër të Planit të Veprimit, janë përcaktuar implikimet financiare dhe korniza kohore për realizimin e planeve.

## Kryesia e Kolegjiut për Arsim punon në procesin e planifikimit

Kryesia e Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë i AKK-së organizoi takimin në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT), ku pjesëmarrës në këtë takim ishin edhe Znj.Dagmar Fuchs-Shmitz udhëheqëse e programit GIZ / CDBE, si dhe Neshat Shaqiri dhe Dukagjin Pupovci, ekspertë të CDBE.

Hapjen e takimit dhe paraqitjen e pikave të rendit të ditës e bëri z. Azem Guri kryesues i Kolegjiut të Arsimit, i cili foli në vija të përgjithshme për procesin e planifikimit nëpër të cilin do të kalojë Kolegjiut për Arsim i AKK-së. Takimin e përshëndeti znj. Dagmar Fuchs-Schmitz, Udhëheqëse e Programit GIZ CDBE e cila premtoi mbështetjen e CDBE për këtë proces planifikimi. Pas prezantimit të procesit të planifikimit strategjik, të cilin e bëri z. Dukagjin Pupovci, u hap diskutimi i cili u përqendrua në pikat lidhur me natyrën e procesit të planifikimit dhe afatet kohore, fushat për analizën

SWOT dhe formimi i Grupi të Planifikimit. Në këtë takim Kryesia e Kolegjiut për Arsim e aprovoi draft-propozimin për organizimin e procesit të planifikimit. Poashtu Kryesia e Kolegjiut për Arsim i përcaktoi pesë fusha për analizën SWOT e cila do të bëhet gjatë punëtorisë së planifikimit: 1) Menaxhimi i arsimit në komuna; 2) Cilësia në arsim; 3) Bashkëpunimi në mes të komunave dhe në nivel regional; 4) Avokimi dhe lobimi; 5) Integrimi i komuniteteve etnike në sistemin e arsimit.

Kryesia përcaktoi strukturën e Grupit për Planifikim, ku, përveç anëtarëve të kryesisë që përfaqësojnë dhe komunat e veta do të përfshihen edhe përfaqësues nga këto Komuna: Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Dragash, Kllokot, Istog, Drenas, Suharekë, Deçan, Shtime, Mamushë. Po ashtu, në planifikim do të ftohen përfaqësues të MASHT, MF, IKAP, BEP dhe të Institutit Pedagogjik.

### PRISHTINË: Për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik nevojitet bashkërendim i të gjitha palëve të interesit

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Prof.Dr.Isa Mustafa, ka çmuar lartë gatishmërinë e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë për të fuqizuar dialogun gjithëpërfshirës dhe për t'i harmonizuar përpjekjet për politika më të mira në favor të bizneseve në vend, me theks të veçantë atyre në Komunën e Prishtinës. Këto komente, Kryetari i Prishtinës i bëri gjatë takimit që zhvilloi me anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe me drejtorin ekzekutiv të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, z. Arian Zeka. Duke e falënderuar Kryetarin Mustafa për vizitën, drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane theksoi se takimet e tilla ndihmojnë në bashkërendimin e qëndrimeve me të gjitha palët e interesit të cilat kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin

ekonomik të vendit, duke potencuar se kjo nuk është përgjegjësi ekskluzive e asnjë institucioni, por është përgjegjësi e tërë shoqërisë në Kosovë. Ai gjithashtu shtoi se takimi i sotëm është i rëndësishëm për dy aspekte meqë Kryetari Mustafa është kryetar i Komunës në të cilën ndodhet numri më i madh i bizneseve, por gjithashtu edhe për faktin se ai drejton njërin prej forcave më të mëdha politike në vend, deputetët e të cilës mund të kontribuojnë në nxjerrjen e ligjeve që lehtësojnë ambientin e të bërit biznes. Ndërsa, Kryetari Mustafa theksoi rolin e rëndësishëm të Odës Amerikane, si organizatë që përfaqëson një zë të fuqishëm të komunitetit të biznesit, por gjithashtu edhe për rolin e saj në promovimin e politikave të Shteteve të

bashkuara të Amerikës. Ai tha se komuna të cilën ai drejton është angazhuar për të koordinuar aktivitetet dhe politikat në mënyrë që të krijohet një ambient më i përshtatshëm, ku bizneset mund të zhvillojnë aktivitetet e tyre. Për më tej, ai theksoi se politikat qeveritare dhe legjislatore përkatës për të bërë biznes, duhet të adresojnë kërkesat e bizneseve që operojnë në Kosovë, si dhe të lehtësojnë tërheqjen e investimeve të huaja. Ai i njoftoi drejtuesit e Odës Amerikane se Komuna e Prishtinës ka marrë vendim për heqjen e taksës së aktivitetit afarist, që do të lehtësojë dukshëm veprimtarinë afariste të ndërmarrjeve në Komunën e Prishtinës.

## Lajme nga Komunat

### KLINË: Shqyrtimi i Projekt-Rregu-llores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane

Është mbajtur debati me publikun, ku rend dite ka qenë shqyrtimi i Projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e komunës së Klinës. Kryesuesi i Kuvendit Fadil Gashi tha se debati është organizuar për here të dytë, pasi që herën e parë qytetaret nuk janë përgjigjur ftesës së debatit. Projekt-Rregulloren e ka sqaruar pikë për pikë zyrtari i zyrës Ligjore Ali Shala, i cili ka thënë se është interes jetik për qytetar të Klinës, ku sot po flasim për struktura e bashkëqeverisjes lokale dhe kjo alternativë nuk i referohet alternativave politike. Qëllimi i rregullores ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave, të përcaktuara në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Për të realizuar sa ma mirë funksionet dhe përgjegjësitë e parapara me ligjin për vetëqeverisje lokale, Komuna e Klinës do të mbështesë zgjedhjen e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetarët e këshillave lokale. Në pamundësi që në çdo fshat, vendbanim dhe lagje urbane të zgjedhen këshillat lokale, atëherë një këshill lokal mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime apo lagje urbane. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë 5 anëtarë: dy anëtarë nga Kuvendi i Komunës, një anëtar nga ekzekutivi, një nga shoqëria civile dhe një nga përfaqë-

suesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet Zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes: uebfaqes, shpalljeve publike, mediave lokale.

### SHTIME: U mbajt diskutimi publik për sigurinë në bashkësi

Në objektin e Komunës së Shtimes, përfaqësues të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, të shoqërisë civile, drejtorë të shkollave, institucioneve komunale etj, përfaqësues të komuniteteve, diskutuan për sigurinë në bashkësi. Në këtë takim pjesëmarrësit përmenden se siguria e përgjithshme në komunën e Shtimes është e mirë, ndërsa në kuptimin e sigurisë njerëzore u përmenden disa çështje që në mënyrë indirekte rrezikojnë jetën e qytetarit siç janë: siguria në komunikacion, mungesa e aparateve të zjarrit në shkolla dhe institucione tjera, vetëdijesimin e të rinjve për dukuritë negative, rrjeti elektrik i vjetër, qentë endacakë etj.

### Fushë-Kosovë: Kërkohe Ministritë të mos japin leje të cilat shkatërrojnë vlerat arkeologjike

Me rastin e fillimit të punimeve nga Konzerciumi Bechtel Enka në vendin e quajtur Gospojë afër fshatit Bardh i Madh dhe Grabovc të komunës së Fushë-Kosovës zyra e kryetarit të komunës lëshon këtë reagim:

Kërkojmë nga Ministritë përkatëse të mos japin pëlqim për hapjen e gurthyesit në vendin e quajtur Gospojë (afër fshatit Bardh i madh dhe Grabovc) nga kompania Bechtel

Enka. Është e pajustificuar dhe me asnjë çmim nuk lejohet prishja e ambientit e cila ka vlera arkeologjike, historike, ujore, botës bimore dhe shtazore.

Banorët e këtyre fshatrave edhe ashtu janë të rrezikuar nga ndotja e madhe e ambientit që vjen nga Feronikeli, Gurthyesit e komunës së Drenasit, Termoelektranat e KEK-ut dhe Mihjes sipërfaqësore në Bardh të madh.

Do të bëjmë të gjitha përpjekjet që të ndalojmë këtë ndërhyrje të egër që po bëhet ndaj natyrës në komunën e Fushë-Kosovës thuhet në reagimin e zyrës për informim të komunës së Fushë-Kosovës.

### MITROVICË: Italianët regjistrojnë kompani

Për herë të parë në Komunën e Mitrovicës është regjistruar një kompani e huaj. Kjo është bërë para disa ditësh nga një grup biznesmenësh italianë, të cilët paraprakisht janë bindur me kushtet e volitshme dhe mundësitë e mira për biznes që ofron Mitrovica.

Kryetari i komunës, Avni Kastrati, i ka inkurajuar biznesmenët italianë që të regjistrojnë kompaninë, duke ju ofruar krejt lehtësirat e mundshme për operim. Në këtë kontekst atyre ju ka ofruar edhe një hapësirë në Parkun e Biznesit, që ata ta kenë një zyrë sa për fillim të biznesit në Mitrovicë.

Duke folur më tepër për këtë rast që jep shpresë për të ardhmen e ekonomisë në Mitrovicë, drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Rrustem Abiti, theksoi se javën që shkoi një grup biznesesh e vizituan Komunën e Mitrovicë, me ç'rast shprehën gatishmërinë që ta themelojnë një biznes në Mitrovicë. "Kjo u bë pasi ata panë që Komuna e Mitrovicës gjithnjë e më shumë është duke krijuar kushte më të volitshme dhe infrastrukturë më të mirë për zhvillimin e biznesit".

# Rekomandimet e AKK-së për

## Projektligjin për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe mbikqyrjen e Tregut

Asociacioni i Komunave të Kosovës e shqyrtoi Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikqyrjen e Tregut me Drejtorët Komunal të Inspektionit dhe Zyrtarët Ligjor Komunal. Konsiderojmë se ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikqyrjen e Tregut ishte më se i nevojshëm dhe i domosdoshëm pasi që ky ligj Komunave iu mori një kompetencë bazike. Pra, me këtë ligj u centralizua një kompetencë, u dobësua buxheti i komunës, u caktuan obligime për komunat në kundërshtim me ligjet tjera, për të ofruar hapësirë për inspektorët e tregut që do të kalonin në nivelin qendror, sigurimi i inventarit, buxheti të transferohej e shumë çështje të tjera. Këto ndryshime ishin jo të drejta edhe në kundërshtim me politikën e vendit për decentralizim, kështu që ishte krejt e kuptueshme që nuk do të kishte mundësi të zbatohesh në praktikë ky ligj. Meqenëse, është në proces të shqyrtimit për t'u ndryshuar dhe plotësuar ligji në fjalë, kërkojmë që: "inspektorët e tregut të kthehen me ligj përsëri nëpër komuna me qëllim të zbatimit të ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës".

### Vërejtjet dhe rekomandimet e AKK-së:

- Emri i Ministrive, nuk duhet shënuar pasi mund të ndërrojnë në të ardhmen, por duhet të qëndrojë termi ministria përkatëse,
- Konsiderojmë se Neni 1, është riformuluar shumë mirë, pasi që mjafton të jetë Ligji për Inspektoratin,
- Neni 2, Qëllimi, pika 2, riformulohet: "Mbikëqyrjen inspektuese nga paragrafi 1 i këtij neni do ta kryej inspektorati i tregut si organ i pavarur i administratës shtetërore i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe si organ i administratës komunale i cili vepron në kuadër të komunave.",
- Te neni 6 mbas pikës 1, duhet të shtohet pikë e re: "2. Organi komunal i inspektoratit përpilon raportin vjetor për kryetarin e komunës ku një kopje i dërgohet edhe kryeinspektorit të tregut në ministrinë përkatëse",
- Te neni 6, ku ceken ndryshimet në nenit 10 të ligjit bazik, paragrafi 6 dhe 7 duhet të mbesin dhe mos të fshihen, kurse neni 10 A, duhet të fshihet komplet. Pasi është në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil,
- Te neni 13 dhe 14, kërkojmë sqarim: A trajtohen si dënime mandatore apo shkelje kundërvajtëse, pasi që dënimet mandatore duhet të jenë fikse, jo të lihen limite prej sa deri në sa? Nëse janë mandatore gjobat të jenë fikse në të kundërtën të trajtohen nga gjykatat,
- Te neni 36 A, shtohet pika nën 3, kjo procedurë inicohet edhe nga inspektori komunal dhe shtetëror.

## Shkurtimisht

- AKK-ja, po merr pjesë aktivisht në takimet e MPB-së, ku po diskutohet çështja e sigurisë në Kosovë, ku rol të madh po luajnë Komunitat.
- AKK-ja po merr pjesë në takimet e ministrive të linjes, për organizimin e ditës së ujit dhe meteorologjisë, për menaxhimin e pyjeve, menaxhimin e mbeturinave, qeverisje lokale dhe decentralizimi etj.
- AKK-ja, po bashkëpunon edhe me GIZ-in projektin në Shqipëri, lidhur me projektin e ndryshimeve klimatike, komunat që kanë probleme me përmytje dhe thatësira (do të jenë pjesë e këtij projekti).
- AKK-ja zhvilloi takim me konsulentët e Bankës Botërore, lidhur me projektin e BB –për investime në Kosovë në vlerë prej 10 milion euro për ngrohje globale (ujë të ngrohtë) për objektet publike, të cilat përdorin në masë më të madhe ujë të ngrohtë.
- AKK-ja është duke shqyrtuar Projektligjin për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje dhe së shpejti do të del me qëndrimin e saj dhe rekomandimet.
- AKK-ja është duke e shqyrtuar Projekt-rregulloren nr.01/2-13, për procedurë e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave- sponzoruar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe së shpejti do të jep rekomandime.
- AKK-ja është anëtar në grupin punues në kuadër të Agjencionit për Barazi Gjinore në bashkëpunim edhe me UN-HABITAT- ku do të hartohet një doracak "Zhvillimi i Çështjeve Gjinore në Procesin e Planifikimit".
- AKK-ja po ndihmon Komunitat në finalizimin e "Model-rregullores për Barazi Gjinore".

## ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS BULETINI

Viti X, Nr. 58 • Janar - Shkurt 2013

PËRGATITI:

Arsim Osmani - MENAXHER PËR KOMUNIKIM

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: [info@komunat-ks.net](mailto:info@komunat-ks.net)

Web: [www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

